



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e 6-të e Legjislacionit të VI-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: 30.05.2018, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora 10:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- | | |
|--------------------------|----------------------------|
| 1. Qaush Balaj, LDK; | 12. Jehonë Haxhijaj, AAK; |
| 2. Besa Ferati, LDK; | 13. Arben Kabashi, PDK; |
| 3. Naim Behlulaj, LDK; | 14. Ajshe Metaj, PDK; |
| 4. Luljeta Zeqiraj, LDK; | 15. Mirushe Sadikaj, PDK; |
| 5. Haki Podrimaj, LDK; | 16. Agron Avdijaj, VV; |
| 6. Selajdin Bytyqi, LDK; | 17. Lavdije Bujupaj, VV; |
| 7. Valbona Demaj, LDK; | 18. Arif Elshani, AE; |
| 8. Edona Lubeniqi, LDK; | 19. Radoš Repanović, SL; |
| 9. Muhamet Ukaj, AAK; | 20. Radenko Belošević, RB; |
| 10. Eliot Kukiqi, AAK; | 21. Slaviša Maliković, SM. |
| 11. Ardita Idrizaj, AAK; | |

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Kryetari i Komunës z. Haki Rugova, Nënkryetari i Komunës z. Lulzim Blakaj, përfaqësues të OSBE-së, KFOR-it, përfaqësues të shoqërisë civile, mediave, disa qytetarë etj (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD-t e xhirimit gjenden në dosje: "shembulli 2").

Mbledhjen e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit z. Qaush Balaj.

Për këtë mbledhje u propozua ky:

R e n d d i t e

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të veprimit për sanimin e gjendjës aktuale e cila mbretëron në NLP "Stacioni i Autobusëve" në Istog
4. Raporti i punës së Ndërmarrjes Publike Lokale "Ambienti " në Istog për vitin 2017,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim Vendimit për plotësimin e vendimit 01Nr.09/2017 të dt.31.01.2017.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim Vendimit për plotësimin e vendimit 01Nr.69/2017 të dt.05.05.2017,

Kryesuesi – propozon që të shtohet edhe një pikë e rendit të ditës formimi i grupit jo formal të grave asamblistë.

Hedhe në miratim këtë pikë të rendit të ditës:

18 vota për, 3 abstenime u vendos:

Miratohet pika e rendit të ditës formimi i grupit jo formal të grave asamblistë.

Arif Elshani, IQ – përshëndet të gjithë të pranishmit, propozon pikë për rendin e ditës për mbledhjen e ardhshme, raporti i punës së prokurimit për vitin 2017, dhe planifikimi për vitin 2018, pasi që vite me radhë këto raportime ne nuk i marrim dhe kërkojmë që në mbledhjen e ardhshme të jenë pika të rendit të ditës.

Arben Kabashi, PDK – përshëndet të gjithë të pranishmit, ka një kërkesë që mbledhjet e Kuvendit të jenë transparente për publikun të transmetohen, kërkon që mbledhjet të transmetohen në radio lokale apo në TV dukagjinin ne kemi pasur një radio që i ka përcjellë por ju ka ndërprerë kontrata para dy vitesh dhe ka mbetur borxh, gjithashtu edhe një kontratë që është shkëputur me TV dukagjinin është përgjegjësi e kuvendit në këtë rast, kjo është kërkesa edhe e qytetarëve që mbledhjet e Kuvendit të transmetohen direkt në çoftë radio apo në ndonjë TV. Propozon që kjo të hyjë si rend ditë të merret një vendim për këtë çështje në këtë mandat.

Propozon që për mbledhjen e ardhshme të ndahen 15 mijë euro për tri klubet të cilat kanë arritur suksese është klubi i futbollit, i hembollit dhe basketbollit, ku të ka mjetë propozoj që të subvencionohen.

Agron Avdiaj, VV – përshëndet të gjithë të pranishmit, pyete a është bërë vlerësimi për demet e breshëritë që ka ndodhur në komunën e Istogut, dhe çka ka marrë komuna konkretisht çfarë masash, thekson një shqetësim tjetër të prishjes së një gypi rrugës ka Trofta që shkon për Vrellë besoj që i ka ma shumë së dy javë a tri me shumë dhe askush nuk ka ndërmarr asgjë, ka filluar të prishet trotuari, sa me gjatë që të shkon kjo gjendje kostoja do të jetë me e madhe e riparimit pse nuk u ndërmarr diçka në këtë drejtim, edhe të shtëpia e kulturës që tri javë është pa rrymë arsyeja pse nuk ka rrymë Shtëpia e Kulturës.

Kryesuesi – hedhe në votim propozimet e Arif Elshanit, raporti i punës së prokurimit për vitin 2017, dhe planifikimi për vitin 2018, që të jenë pika për rend dite në mbledhjen e ardhshme. Hedh në votim:

Me13 vota për, kundër 7

Miratohet që në mbledhjen e kaluar të hy si pika të rendit të ditës raporti i punës së prokurimit për vitin 2017, dhe planifikimi për vitin 2018.

Kemi propozimin tjetër nga Arben Kabashi të ndahen 15 mijë euro për futboll, hëmboll dhe basketboll që kanë arritur sukses. Fjalën ja kalon Kryetari.

Kryetari i Komunës – përshëndet të gjithë të pranishmit, duhet të kemi kujdes gjatë propozimeve, raporti i prokurimit ka shkuar në KRPP dhe është publik në ueb faqe zyrtare të komunës, edhe Kuvendi do të njoftohet me këtë raport dhe me planifikimin, sportet ne i përkrahim i subvencionojmë me aq buxhet sa ka komuna, ndërsa këto që po kërkon ju ne duhet të dim a janë këto mjetë në buxhetin e komunës dhe ku duhet me i marr nga cili drejtori kjo është mirë shumë jam i lumtur që kjo kanë fitu, ka qenë një vit i kirë për klubet tona në Istog, ka mjaftë biznese që i përkrahin këto klube, komuna vetëm nuk mund ti mban klubet, në përqindje me të madhe për subvencionimin e sporteve është komuna e Istogut , kjo ka qenë çdoherë. Thotë se është për tu ndihmuar sporteve të hecin përpara vetëm të ceken ku do të merren mjetet dhe të qitni në votim nuk ka as një problem.

Agron Avdiaj, VV – thotë se me sa e ka kuptuar Arbenin për subvencionimin e sporteve tha ta vëmë në diskutim dhe pastaj me shiku a ka mundësi apo jo të analizohet si mundësi, qoftë edhe si kjo që e përmendi kryetari bizneset pse mos të ndërmerret një hap tjetër me i promovu edhe ato biznese të cilat kontribuojnë në çështjen sociale apo kulturore me shumë një far forme me i nxit edhe bizneset që me kontribu me shumë në këtë drejtim

Kryetari i Komunës – ne me biznese e bëjmë këtë punë vazhdimisht dhe i përkrahim klubet sportive në vazhdimësi.

Arif Elshani, IQ - dëshiron të ndërlidhet me fjalimin e Kryetarit, dhe thotë se si anëtar i Kuvendit ka të drejt të propozoj dhe çështje e Kuvendit është a e aprovon a jo, ne e kemi pasur raportin e Zyrës së prokurimit para dy muajsh dhe asgjë nuk kemi qitur thotë që ka bërë kërkesë për këto raporte zyra e Prokurimit jap informata se nuk din çka janë ato, mendon se ma transparent që duhet të jetë në komunën e Istogut e cila është me së Pakti është zyra e Prokurimit pse mos të kem raportin që tri vite që bisedojmë dhe as një herë raport nuk kemi vetëm një her ka dal zonja aty dhe asgjë, me interesojnë me shumë çka po ngjanë me zyrën e prokurimit, pres mbledhjen e ardhshme të kemi në diskutim si pikë të rendit të ditës.

Kryetari i Komunës - i keni parë edhe vlerësimet për komuna dhe komuna e Istogut është në katër komunat e para për transparencë.

Arben Kabashi, PDK - nuk thash që komuna e Istogut nuk i ka përkrahur sportet, keni parë komunën e Gjakovës kanë ndare dikund mbi 24 mijë euro nga Kuvendi

Komunal i ka subvencionuar ato klube që kanë pasur ngritjes apo performancë të mirë. Kërkova që këto 15 mijë euro të subvencionohen ku të merren ideja është nga zyra e kryetarit pasi që besoj së kryetari ka buxhet për këso rastesh po kërkova për shkak edhe që është rishikimi i buxhetit muajin e ardhshëm që të gjendet një formë edhe të subvencionohen disa klube për të arriturat që i kanë pasur. Propozimi është i imi e ka i merrni ju mjetet është e juaja.

Kryetari i Komunës - nëse e kontrolloni mirë buxhetin në zyrën e kryetarit ekziston një kod përkrahja e projekteve në infrastruktura me donator dhe me qytetar dhe as një cent të atyre kodeve pa leje nuk mund të shkoj dikund tjetër, ndërsa për sport e ki në buxhet sa ka mjetë NDOSHTA mund të ju përgjigjet dikush këtu, ato mjete a duhet ti marrim nga bujqësia apo dikund ndonjë drejtorati tjetër, janë disa procedura JAMË për këtë propozim nuk jam kundër as një mënyrë vetëm që duhet ekzekutivi të bëjë vlerësimin se ku mund të i marrim këto mjete.

Nënkryetari i Komunës - përshëndet të gjithë të pranishmit, sqaron së në programin buxhetor të Arsimit dhe Kulturës është kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transferove në atë kategori janë të parapara përkrahja e klubeve të sporteve që funksionojnë në komunën tonë deri më tani janë përkrahur klubi i futbollit, i hembollit, basketbollit, shahit dhe karatesë përkrahja e tyre është bërë në proporcion me prioritetet dhe shpenzimet që i bëjmë për zhvillimin e garave në kategorit në të cilat janë ato momentalisht për momentin klubin e hembollit janë ndare 6000euro për këtë vit dhe kryetari për arritjet i ka shpërblyer të gjitha lojtarët më 1600 euro si përkrahje për arritjet në këto gara, po ashtu edhe klubi i basketbollit është përkrahur ekziston plani i përkrahjes së këtyre klubeve të cilat përkrahen rregullisht. Vitin e kaluar më shumë së 30mijë euro është përkrahur klubi i futbollit Istogu në përkrahje po llogaritet edhe ushqimi i lojtarëve dhe transporti edhe disa shpenzime tjera. Nëse dëshironi të parashihet edhe një shtesë tjetër prej 15 mijë euro ashtu siç tha edhe Kryetari duhet të merret dikund nga subvencionet sepse nuk mund të marrim nga kategoritë tjera.

Lulzim Shoshi, Drejtor i Bujqësis - përshëndet të gjithë të pranishmit, përgjigjet në pyetjen e Agronit, se kanë dalur në teren dhe kanë evident dëmet e breshëritë kemi formuar komisionin. Kemi raste të dëmeve me zë mëdha ku i dërgojmë në Ministri për vlerësim dhe ata e bëjnë pagesën e dëmit.

Enver Rugova, Drejtor i Shërbimeve Publike - përshëndet të gjithë të pranishmit, Është një plakje e gypave në kodër të mullinjve trofta ka intervenuar aty është e shtat herë, mirëpo kësaj radhë ujerat e mëdha që vinë nuk kanë mundur me i përballu dhe rrjedhja ka shkuar me tutje pa dashur me ikur përgjegjësi dhe kompetencave që i ka Komuna ajo është pikërisht në menaxhimin e Kompanisë regjionale Drini i bardh në bashkëpunim që është shfrytëzuese edhe hotel Trofta vazhdimisht kemi qene në kontakt edhe me përfaqësuesit të Drinit të bardh dhe kompetent e hotel trofta aty është një problem i madh nuk mundë të ndalet uji dhe të kryhet sepse me ata uji furnizohet trofta ajo pjesa e djathtë aneje tek hurdha ku shumohen peshqit aty një gabim me i vogël, nuk jemi me i dëmtuar kompanitë është njëra ndër kompania e pakta që rezulton pozitivisht në buxhetin financiar, pa dashur ta dëmtojnë ka ardhur deri në këtë kohë kemi ftuar një inxhinier të kësaj fushe që lyp një kohë të evitohet pa dëmin e kompanisë.

Hajrush Shoshi, Drejtor për Arsim dhe Kulturë - përshëndetje për të gjithë, sa i përket defekti që ka ndodhur në shtëpinë e kulturës pa rrymë është defekt nëntokësorë ku kabloja e rrymës është dëmtuar, kemi intervenuar aty është angazhuar KEDS-i ku bësh se shumë shpejt do të rregullohet.

Arben Kabashi, PDK - ku po mbetet propozimi im duhet të bëjmë një zgjidhje?

Kryesuesi - mbret që në rishikim nëse gjendet ndonjë formë do të marrim ndonjë vendim në mbledhjen e ardhshme.

Arben Kabashi, PDK - e për transmetim të mbledhjeve çka do të merret?

Kryesuesi - jemi në procedura të një zgjidhje besoj që do të vendoset shumë shpejt.

Hedhë në miratim rendin e ditës

Kuvendi i Komunës me 17 vota për, dhe 3 abstenime vendosi:

Miratohet rendi i ditës.

Shqyrtimi i pikës 1.

Në mbledhje munguan tre anëtarët e Kuvendit të Komunës, Zenel Shatri LDK, Nanim Imeraj AAK dhe Negjmedin Balaj AAK, si dhe tre anëtar që ende nuk janë zëvendësuar nga KQZ-ja për shkak se ata ende nuk i kanë zgjedhur anëtarët dhe ne jemi sot vetëm me 21 anëtar prezentë.

Shqyrtimi i pikës 2.

Kryesuesi – vazhdojmë me miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Radenko Belošević - në nuk e kemi të gjithë materialin e përkthyer ashtu siç është në shqip kemi kërkuar nga Vjosa por nuk na u është kthyer asgjë.

Kryesuesi - do të përkthehen nuk do të ndodhen me.

Pasi që nuk pati vërejtje në procesverbal, Kuvendi i Komunës vendosi:

Miratohet procesverbali i mbledhjes së kaluar pa vërejtje

Shqyrtimi i pikës 3

Kryesuesi – vazhdojmë me piken e tretë të rendit të ditës Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të veprimit për sanimin e gjendjes aktuale e cila mbretëron në NLP “Stacioni i Autobusëve” në Istog, kemi pasur ko që ta analizojmë këtë rregullore kemi pasur dëgjimin publik.

Agron Avdiaj, VV - ne edhe në mbledhjen e kaluar e diskutuma dhe u pa shumë shqetësuese gjendja e Stacionit të Autobusëve, dhe arsyeja pse me ndërmarr këtë është një plan i veprimit për me përmirësuar këtë gjendje, besova shumë që një plan i veprimit ka me qenë shumë me i kompletuar se ky që është tani, ky që është tani nuk e di si ta quaj planë veprimi. Plani i veprimit duhet të jetë më konkret me i detajuar, ndërsa këtu po i shohim disa pika që një mendim e shkrinë në disa pika me të gjana se sa këta. Prandaj ky plan i veprimit si i tillë nuk konsideroj që duhet të votohet lë të shtyhet për një mbledhje tjetër.

Arif Elshani, IQ - jep disa sqarime për Stacionin e Autobusëve për mandatin e kaluar, pasi që isha i propozuar nga opozita që të jem pjesë e përfaqësimit, në kemi qenë të përzgjedhur 2 nga Kuvendi dhe drejtori i shërbimeve publike detyra Jon ka qenë të përzgjedhim bordin në kemi përzgjedhur bordin, se në mbledhjen e kaluar është thënë se ka më bërë pak për atë punë kam marr pjesë se paku 4 herë në mbledhje mendoj se si anëtar i Kuvendit nuk kam pasur mundësi e as nevojë që të jem pjesë në mbledhje të bordit, nëse një anëtar i bordit nuk merr pjesë në mbledhje jam që ata anëtar të zhgarëkohën dhe të emërohen anëtar të cilët marrin pjesë në mbledhje. Sa i përket planit nuk do të flas shumë por nuk kam pasur qejf me pa emrin e Enverit se Enveri thotë se jam i deshëm intelektual dhe një plan i tillë nuk është i tillë.

Raporti i mbledhjes së kaluar shihet se gjërat janë të cekura shumë kjoartë ku del se Stacioni i Autobusëve ka 26 mijë euro borxh, ne e dimi se stacioni i autobusëve është pronë komunale përgjegjësi mbi ne dhe propozoj që në rishikim të buxhetit t'i sigurohen me së paku 30 mijë euro, ajo kompani duhet të mbijetoj ata nuk mundën në këtë gjendje nuk kanë marrë dhjetë paga plus një punëtor të punoj pa pagë nuk ka më koment për këtë. Propozon që në rishikim zë sigurohen 30 mijë euro dhe ti sigurohen atyre mbijetesa së pari, dhe të merret vendim ai duhet të ekzistoj aj stacion apo jo.

Eliot Kukiqi, AAK - përshëndet të gjithë të pranishmit, në KPF kanë rekomanduar të sillet plani operues financiar për ndërmarrjen nëse ka kërkesa qfar duhet të ndërmarrë komuna, nuk e përkrahi këtë plan veprimi këto kërkesa pa plan realizimi janë të kota së pari analiza e të hyrave dhe të dalave e pastaj të kërkohet ndihma.

Arben Kabashi, AAK - drejtori na ka sjellur një planë i cili i ka 68 shkronja analizoni mirë dhe e ka quajtur planë veprimi, ndërsa këtu po flasim për një kompani e cila është e falimentume, Enver kur e ki menduar këtë plan Veprimi është dashur ta dish se për të njëjtin duhet me i plotësuar disa kritere me bë një përshkrim komplet edhe me të strukturuar me i përcaktu afatet kohore kurë duhet me fillua dhe më përfund, buxhetin sa kosto ka kjo ku më i marr mjetet si me i shpenzu, resurset njerzore sa njerëz nevojiten me zbatuar planin e veprimit kush do të jëtë përgjegjës dhe në fund cilat janë pritshmërisë tona, a po realizohen pritshmërisë në afatin e caktuar apo jo, nëse jo atëherë me fillu me

zbatimin e planit tjetër. Për shembull në pikën e par e keni shkruar mungesa e inspektorit të komunikacionit, çka nënkupton kjo Enver ku janë përfitimet e Kompanisë. Mendoj se dokumenti duhet të i kthehet mbrapa drejtorisë apo drejtorit dhe kur të jetë i gatshëm lë ta sjell prapa në Kuvend.

Radoš Repanović, SL – ne mendojmë se ky nuk është plan i veprimit këtu janë vetëm disa fjalë dhe nuk e përkrahim këtë.

Naim Behlulaj, LDK - përshëndet të gjithë të pranishmit, thotë që kur të marrim fjalën të japim ide se si të dalim nga kjo krizë, ndërsa sa i përket planit mos të ngutemi shumë Enveri ka bërë një raport në pika të shkurtëra, ky ka me elaboruar dhe ka me na dhënë informatë ma të detajuara, propozojë që të japim ide e jo kritika. T'ia dhëm fjalën drejtorit të na prezanton planin.

Muhamet Ukaj, AAK - përshëndet të gjithë të pranishmit, e konsideron që problemi është dashur të merret me seriozisht, në bazë të diskutime kam vërejtur se ka neglizhence edhe nga ana e shërbimeve policore edhe nga disponimi i këtyre privat me autobusë, nëse seriozisht në dëshirojmë të merremi me këtë problem në ish dashur të i nxisin organet e punëve të brendshme me këta të autobusëve që të hynë së Stacioni thërret që të jenë me serioz në këtë punë.

Enver Rugova, drejtor i shërbimeve publike - përshëndet të gjithë të pranishmit, bënë prezantimin dhe sqarimin e Planit të Veprimit për sanimin e gjendjes aktuale në Stacionin e Autobusëve në Istog.

Arif Elshani, IQ - ne duhet të dimi vendin ku e kemi nëse Enveri nuk është anëtar i Kuvendit nuk duhet ti ofendoj këta njerëz që nuk dinë, mendoj që këta dinë kanë shkollë, drejtori nuk ka nevojë të na ofendoj, e thamë mendimin tonë që është një planë jo i plotësuar, nuk do ta votoj këtë plan.

Arben Kabashi, PDK - ne jemi anëtar të Kuvendit nuk kemi nevojë të shtyhem por duhet të japim përgjegjësi para qytetareve jemi të gatshëm të ballafaqohemi edhe politikisht edhe për çështjet që janë në prioritet në pika të caktuara sa i përket këtijë plani të veprimit, ta rikujton kolegu Enver këto 7 pika që i ki bë këto janë në rregullore dhe nuk janë zbatuar se me u pas zbatuar këto 7 pika që sot janë në Kuvend çdo gjë kishte me qenë në rregull, ku është përgjegjësia të t'i dhe të ish drejtori, ta thash shumë mirë se si duhet me i përcaktuar pikat po ta rikujton edhe një herë afatet kohore, buxhetin, resurset njerëzorë dhe pritshmëri afati kohorë. Këto nuk i ki të cekura askund këto janë 7 pika që nuk janë zbatuar dhe jemi ardhur në këtë gjendje ku jemi direkt po dëmtohet qytetari sepse po kërkohet direkt me u tërheq dokumentet nga një kategori buxheti e me ja dedikuar stacionit të autobusëve, jam me ju ndihmua këtë kompani për shkak se e keni pru në këtë gjendje se çfarë është sot.

Radoš Repanović, SL – jo korrekt nga drejtori Rugova mos të mbyllet të funksionoj Stacioni i Autobusëve në Istog , ndërsa plani është gabim nuk ja vlen të bëhet një planë i detajuar si të del nga kriza, jo të mbyllet Stacioni, ne nuk do ta votojmë këtë plan.

Agron Avdiaj, VV - nuk mund të thuhet se nuk ke që profesional, sepse ndonjëherë kur donë me i ik përgjegjësës është me lehtë me ik me dy apo tre rreshta është zor me u kap në data në persona përgjegjës, prandaj në nuk them që jemi kundër stacionit të autobusëve jemi kundër këtij plani që duhet me i përmbajt disa elemente konkrete. Sepse kurë t'i përmend elementet kush është përgjegjës çoftë institucioni apo personi për shembull bashkëpunimi dhe veprimi me shoqata të transportit ndër urbanë kjo është shumë e gjere, një takim mund ta keni në katër vjet dhe mund të thoni po jemi taku, por ti duhesh të thuash takime të rregullta 3 mujore dhe në raportim të kësaj ti thua ai janë mbajtur atë jo ku janë fajet. Jam i pajtimit që mos me bë letra shumë po edhe mosveprimi ku sh përputhet bënë letra shumë është anomali dhe e kundërta nëse bënë punë shumë të mira dhe me letra nuk je askund prape është anomali. Në këtë plan të veprimit ka vetëm objektiva ky nuk është planë. Në planë objektivat duhet të ndahen të zërthehen.

Enver Rugova, drejtor i shërbimeve publike - po Vjenë nga mandati i kaluar të përsëritur shumë këto probleme, fillimi është të mungesa e inspektorit të komunikacionit do të shpallet konkursi së pari me kontrata mbi vepër një inxhinier të komunikacionit sipas profilit të kërkuar. Të subvencionimi nuk mund të japim datë njëherë sepse jemi intensivisht duke punuar ku mund të ndërhyhet në aspekt buxhetor një shumë sa me të madhe tua alokojm zbatimi i rregullores komunale është që tri vite Rregullorja i bënë në vjeshtë Ajo duhet me u zbatua, edhe bashkëpunimi me shoqatat ne vazhdimisht kontaktojnë me to Me së paku në baza mujore. Përcaktimi dhe rregullimin e vend qëndrimeve të taksive kjo është shumë me rëndësi në aspekt të rregullit në komunikacion edhe me pas një vend qytetarët ku me u adresua. Nëse ju jeni kundër këtyre pikave ata falimenton. Kemi me i ndaluar disa rrugë një kahesh.

Nënkryetari i Komunës - qëllimi i gjithë neve këtu është funksionimi i Stacionit të Autobusëve, në radhë të parë për arsye të sigurisë së nxënësve, rregullimit të trafikut dhe rregullimit të stafit aty. Debati u sollën të ky planë të jetë i formuluar në mënyrë narrative sidomos për aktivitetet për mbështetje financiare, ne nuk mund të diskutojmë për mbështetje financiare të kompanive por vetëm për aktivitete që duhet në me i ndërmarr që kjo me u funksionalizuar që të u krijohen kushte ta mbanë vetën një ndër kushtet ka mëndu drejtoritë i shërbimeve publikua kanë qenë edhe këto në planë ashtu siç janë cekur, propozon që të miratohet si e tillë por të obligohet drejtori që Kuvendin të njoftoj për çdo mbledhje për të arriturat dhe të metat e Stacionit.

Ndërlidhna me propozimin e Arif Elshanit që të subvencionohet Stacioni i Autobusëve bile së paku të bihet në nivelin zero zero mos të ketë borxhe ndaj ATK- së etj. Patë shumë propozime me të cilat pajtohem se janë të arsyeshme.

Radoš Repanović, SL – mos mendoni se ne dojmë me e mbyllë Stacionin e Autobusëve ne nuk do ta votojmë, të sillet në mbledhjen e ardhshme të na sillet në mbledhjen e mbledhjen e ardhshme të na sillet ashtu siç mendon me çka është në interes të qytetareve ne do ta votojmë, pse nuk e keni përfshi Rakoshin në këtë raport edhe atje ka qytetar është rruga për Mitrovicë.

Arif Elshani, IQ - mendoj që nënkryetari ka dy përgjegjësit me të mëdha një që thotë se komuna nuk mund të ndaj mjete për Stacionin e Autobusëve, ku kjo është pronë

komunale dhe aksionar është Komuna dhe është dashur një planë i mirë i detajuar mirë dhe Enveri ish dashur me bë.

Nënkryetari i Komunës - edhe në mbledhjen e kaluar kur kemi debatuar për raportin e Stacionit të Autobusëve në mënyrë detale janë përfshirë të gjitha atë edhe shpenzimet edhe ecuria edhe kahja të gjitha mirë po janë paraqitur të gjitha propozimet që mendojnë që duhet me u zgjedh me funksionalizuar Stacioni e në frymën e ati raporti janë realizuar edhe këto pikat e këtij plani operativ, ju vendosni.

Agron Avdiaj, VV - është përgjegjësi edhe për në me votua këtë plan veprimi në piknik më shkua ish dashur me u shtri pak ma shumë e jo një plan i veprimit për stacionin e Autobusëve propozon që të subvencionohet sa të mbulohen borxhet dhe ky planë të modifikohet për mbledhjen e ardhshme.

Arben Kabashi, PDK - kamë propozuar që ky planë me u strukturuar me i pas në dokument me dit çka po votojmë.

Hedhë në miratim piken e rendit të ditës:

Kuvendi i Komunës me 11 vota për vendosi:

Miratohet që ky planë të shtyhet për mbledhjen tjetër të plotësohet dhe të sillet për miratim prap.

Shqyrtimi i pikës 4

Kryesuesi – propozon që të vazhdohet me piken e katërt të rendit të ditës, Raporti i punës së Ndërmarrjes Publike Lokale “Ambienti “ në Istog për vitin 2017

Sadik Bujupaj, drejtor i Ndërmarrjes ambienti, përshëndet të gjithë të pranishmit, bënë prezantimin dhe sqarimin e Raportit të punës së Ndërmarrjes Publike Lokale “Ambienti “ në Istog për vitin 2017

Eliot Kukiqi, AAK - duke u bazuar në raportin e viti 2016 - 2017, është 77 më shumë ky është mirë, inkasimi 2017 është 79 % është mirë, por kur i analizave shpenzimet i pash se të gjitha shpenzimet veç e veç të cekura kanë pasur një rritje normë në krahasim me vitin 2016 këto shpenzime janë rritur për 83%. Duke bërë inkasimin e rritjes së shpenzimeve del së me shumë se për 1045 euro ka pasur me shumë shpenzime se inkasim çka mua si ekonomisë nuk me pëlqeu, ku shpenzimet rriten me shumë së inkasimi, sipas mendimit tim ajo ndërmarrje që i ka shpenzimet me të mëdha së të hyrat shkon drejt falimentimit rekomandoj të ri shqyrtohet edhe njëherë plani imperues i ndërmarrjes të shikohen mundësit e uljes së shpenzimeve dhe të bëhet presion në inkasim në bazë të Raportit që e keni ofruar ju dhe analizave të mia se ndërmarrja Ambienti në vitin 2017 është minus 137.07euro.

Arben Kabashi, AAK - është një raport i detajuar shumë mirë, pyete ai ka dështuar për gjetjen e një lokacioni të Toqep personalisht e kam vizituar atë vend ku gjuhën mbeturinat, dhe shumë ankesa pata nga qytetarët aty afër keni ndërmarr diçka të gjindtë një lokacion me i mirë. Në raport përmendet inkasomi i madhe kjo ka qenë sepse ka qenë kushtëzimi me regjistrimin e veturave në atë kohë përmendet që në 12 muaj të vitit janë mbajtur 8 mbledhje për ata niveli i të hyrave është pak më i ulët janë të punësuar 30 veta këtu përmendet Gurrakoc ku thuhet se disa herë është bërë edhe larja e rrugëve, unë jetoj aty dhe qendra e Gurakocit është katastrofë jo vetëm sa i përket mbeturinave, ftoj të merret me seriozisht qendra e Gurrakoc.

Agron Avdiaj, VV - pyet mu duk së drejtori e përmendi që vitin e ardhshëm të Përfshihet shtrirja 100% e gjithë territorit të komunës së Istogut, nëse është ashtu po mendoj që është synim kogja ambicioz dhe a jeni bazuar veç në këtë projektin e Gizit apo ka edhe ndonjë donacion sepse mendoj që projekti i Gizit mund ta bëj shtrirjen por qëndrueshmëria pastaj si do të jetë.

Arif Elshani, IQ - Pyet drejtorin ai është drejtor i zgjedhur apo është me kontratë, e inkurajoj për punën e bërë po besoj që edhe në opozita kurë është mirë dimë me thënë që është mirë, ka nevojë me i ndihmuar por ndihmat nuk janë aq të mëdha.

Naim Behlulaj, LDK - e përgëzon drejtorin për punën e bërë se Istogu njihet një ndër qytetet më të pastërti në Kosovë vendi i mbeturinave në Treg ka shumë ankesa djegja e tyre, a ka mundësi që këto mbeturina mis të digjen dhe pyetja dy a keni planë konkrete për fshatrat Rakosh, Uçë, Zhakovë sidomos nëpër lumin që kalon nëpër Rakosh dhe Uçë është një prej lumenjve me të ndotur.

Radoš Repanović, SL – ju silleni si me qenë ajo ndërmarrja juaj private, kontejnerët janë të tonët jo të juajt, kërkova me bë një deponim të përkohshme, nuk është shumë e vogël për qytetaret me paguar 4. 60 cent në muaj ose 70 euro në vit

Arben Kabashi, PDK - përshëndeti iniciativën që e kanë marr hekur e kontejnerëve neper lagje dhe mbeturinat i qesin me qese.

Sadik Bujupaj, drejtor i ndërmarrjes Ambienti - jam drejtor i zgjedhur me konkurs regjional, 2016 janë fakturuara 2664 ndërsa në 2017 janë fakturuar mbi 364 mijë gjithsejtë inkasimi me TVSh në 2016 221mijë ndërsa në 2017 është 276 mijë kjo rritje është për shkak të borxhit se është shumë pak, por për shkak të kushtëzimit se është hekur. Furnizohen me për krejt mekanikët ku gjejmë pjesë dhe duhet të marrim me çmime të ndryshme, Bageri është djegur në Toqep po atë ditë si na ka ble komuna gomat e reja.

Deponim në Toqep është në gjendje shumë të keqe, depozita nuk kallet nga punëtoret e Ambientit, po me duket se edhe kjo deponim do të hiqet Gurrakoc, Vrella dhe Banja fshihen dy herë në muaj ndonjëherë ka ndodhur edhe një herë në muaj Banja për shkak të mungesë së punëtoreve. Në Gurrakoc nuk

është larë por për një larje i kam bërë 3 stërpikje. Të shtrirja nëse e realizojmë atë projekt të Gizit që shpresoj shumë deri në fund të vitit, nga ta do të kërkoj se paku 3 kamionë deri në 7 apo 8 vite sepse të ri nuk na bien dhe me këta kamion do të mbulohet krejt komuna e Istogut. Osojani kamë kërkuar nga Vesna që të thërras banorët e të flasim, ajo thotë nuk ka kontejner dhe as njerëz që paguajnë.

Naim Behlulaj, LDK - në Rakosh as një herë nuk kemi par kamion duke pastruar, është mirë që të pastrohet edhe atje. Nuk është pjesë e madhe.

Sadik Bujupaj, drejtor i ndërmarrjes Ambienti - në ato fshatra ka probleme me ujin e pijes një herë kemi shkua me stërpik dhe kemi pasur problem nga qytetarët se nuk po kemi uji me pi dhe e kom ndaj, dhe jemi mundur me ju ndihmu me ujë kemi bartë për pirje kemi një sistemi të vjetër dhe me atë. Por do të pastrojmë edhe Rakoshin.

Naim Behlulaj, LDK - në shkollën tre dëshmorët paguhet tarifa për mbeturina dhe atyre shumë në atë kontejner i djegur mbeturinat as një herë nuk vini mirë hjekë nga aty.

Sadik Bujupaj, drejtor i ndërmarrjes ambienti - aty ne kemi folur me mirë mbajtësin e asaj shkolla që të na thërret si të mbushet aj kontejner në shkojmë e hjekim por aj nuk na thërret as një here i djeg mbeturinat i kam tregu se është e dëmshme nuk bënë të djegën por pa rezultate.

Lavdiqe Bujupaj, VV – përshëndet të gjithë të pranishmit, parashtroon shqetësimin e saj se në lagjen e spitalit është një deponi e vrazhd ku të gjithë banorët e asaj lagje gjuajn mbeturinat aty dhe i djegun ato mbeturina qfar të bëjmë ne si banor se jemi të shqetësuar.

Sadik Bujupaj – ne në atë lagje mund ti bim kontejnerët vetëm se duhet të paguajnë qytetarët prandaj, ata nuk janë të gatshëm të paguajnë dhe i kanë refuzuar kontejnerët.

Kryesuesi - pasi që diskutime tjera nuk ka kalojmë ne piken e radhës.

Shqyrtimi i pikës 5

Kryesuesi - propozon që të vazhdohet me piken e pestë të rendit të ditës, Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim Vendimit për plotësimin e vendimit 01Nr.09/2017 të dt.31.01.2017,

Nënkryetari i Komunës – prezantoi dhe sqaron Propozim Vendimit për plotësimin e vendimit 01Nr.09/2017 të dt.31.01.2017

Kuvendi komunal më 12 vota për, dhe 5 abstenime vendosi:
Që i Propozim Vendimit për plotësimin e vendimit 01Nr.09/2017 të dt.31.01.2017,

Miraton me shumicë votash.

Shqyrtimi i pikës 6

Kryesuesi - propozon që të vazhdohet me piken e gjashtë të rendit të ditës Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim Vendimit për plotësimin e vendimit 01Nr.69/2017 të dt.05.05.2017;

Nënkryetari i Komunës – prezantoi dhe sqaron i Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim Vendimit për plotësimin e vendimit 01Nr.09/2017 të dt.31.01.2017

Kuvendi komunal më 12 vota për, dhe 5 abstenime vendosi:
Që i Propozim Vendimit për plotësimin e vendimit 01Nr.69/2017 të dt.05.05.2017,

Miraton me shumicë votash.

Shqyrtimi i pikës 7


Kryesuesi - propozon që të vazhdohet me piken e shtatë të rendit të ditës, formimi i grupit jo formal të grave asamblistë

U vendos që Ajshe Metaj të jetë Kryesuese e këtij Grupi jo formal, si dhe mbetet mundësia që sipas marrëveshjes së anëtareve mes vetes të ndërrohet edhe me rrotacion

Pasi që nuk pati diskutime të tjera, Kryesuesi shpalli të mbyllur mbledhjen e Kuvendit të Komunës.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 12:40.

Procesmbajtëse,
Vjosa Hysenaj



Kryesues,
Qaush Balaj

